



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 29/1 dt.28.02.1996

Këshilli Bashkiak i Qytetit Tiranës, i mbledhur sot me dt.28.02.1996, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Seksioni i Transportit, lidhur me çdëmtimin e mjeteve të transportit të dëmtuara nga Akti Terrorist i dt.26.02.1996 pranë supermarketit “Vefa” në qendër të Tiranës. Mbështetur dhe në V.K.M Nr.154, dt.04.03.1996 “Për mënjanimin e dëmeve të shkaktuara nga akti terrorist i dt.26.02.1996” për fondet e miratuara për këtë qëllim,

VENDOSI

1. Të miratojë fondin 1.984.850 lekë për çdëmtimin e mjeteve të dëmtuar gjatë aktit terrorist të dt.26.02.1996 në qendër të Tiranës sipas konfirmimit të grupit ekspert të INSIG Tiranë dhe Rajonit Nr.3 të Policisë Tiranë.
2. Ky fond të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Transportit dhe Drejtoria e Administrimit Financiar dhe Zyra e Llogarisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA